



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 14 prot.

Kamëz, më 22 .01. 2024

V E N D I M

Nr 14 Datë 22 / 01 / 2024

P Ë R

**“KOMPESIMIN E BILETËS SË PAJTIMIT MUJOR, TË PËRGJITHSHËM  
(ABONESË SË STUDENTIT) PËR STUDENTËT E PAJISUR ME KARTË STUDENTI  
PËR TË GJITHË LINJAT E TRANSPORTIT NË BASHKINË KAMËZ”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 22.01.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.11 Datë 18.01.2024 Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 23, nenit 35, nenit 55, pikat 2 dhe pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 113 të Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” nenit 100 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, vendimit nr. 226, datë 17.4.2019 të Këshillit të Ministrave “Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studenti”, **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e kompesimit të biletës së pajtimit mujor, të përgjithshëm (Abonesë së studentit) për studentët e pajisur me kartë studenti për të gjitha linjat, në Bashkinë Kamëz për periudhën Janar-Dhjetor 2024, sipas strukturës buxhetore Gr.0, Progr.4130, Kap.5, Art 602.
2. Numri i aboneve të studentit që do të rimburosohen përcaktohet nga numri i gjenerimit të kartave të studentit.
3. Kompesimi ndaj operatorëve të licensuar në transportin publik qytetës në Bashkinë Kamëz, bëhet nga Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit, sipas volumit të aboneve të shitura për secilin operator.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

4. Operatorët dorëzojnë çdo muaj pranë Drejtorisë së Financës dhe Kontabilitetit në Bashkinë Kamëz, dokumentacionin si më poshtë:
  - a. Numri i Niptit;
  - b. Numri i Licensës;
  - c. Shuma për tu paguar;
  - d. Numrin e llogarisë bankare;
  - e. Faturën tatimore;
5. Ngarkohen Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit, Drejtoria e Transportit dhe Liçensave, si dhe çdo strukturë tjetër e Bashkisë Kamëz për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

  
**KRYETAR KËSHILLI**  
**Hysen KOLDASHI**

